

Bazuar në monitorimin gjashtë mujor të shtatë komunave, Demokraci Plus ka bërë një vlerësim të nivelit të përmbushjes së gjashtë parimeve të qeverisjes së mirë për të cilat kryetarët e këtyre komunave, sa kanë qenë kandidatë për këtë post, janë zotuar me nënshkrim se do ti përmbushin në rast se zgjedhen.

Gjetjet tona të monitorimit tregojnë se në përgjithësi publikimi i dokumenteve publike në ueb-faqe është përmbushur apo kryesisht i përmbushur, përveç në Komunën e Gjilanit ku numri i vendimeve të publikuara del jashtë zakonisht i ulët. Po ashtu, edhe publikimi i raporteve financiare del të jetë kryesisht i përmbushur, edhe pse standardet e raportimit dhe detajet e raportimit dallojnë nga komuna në komunë.

Në procesin e konsultimeve publike tri nga katër komuna i japin rëndësi numrit dhe cilësisë së këtyre mekanizmave të kontaktit me qytetarë, ndërsa kryetarët e komunave tjera kanë mjaft hapësirë për përmirësim, jo vetëm numri i konsultimeve por edhe prezantimi i informatave bazike për konsultim, pjesëmarrje të zyrtarëve të lartë dhe llogaridhënia në këto ngjarje me qytetarë.

Inkurajuese që të gjitha nga shtatë komunat kanë bërë përpjekje të mbajnë së paku tri konsultime publike, qoftë për buxhet, rregullore komunale apo plane rregulluese, megjithatë për qeverisje komunale kjo është mjaft e ulët.

Përparim ka patur në transparencë të prokurimit publik, përpos në Komunën e Mitrovicës dhe Komunën e Ferizajt që nuk janë të publikuar pjesa më e madhe kontratave. Ndërsa në Komunën e Gjilanit, vetëm gjysma e kontratave të nënshkruara dalin të jenë të publikuara në ueb-faqe.

Zotimi që më së paku është përmbushur nga shtatë komunat është publikimi i raportit për progresin e realizimit të premtimeve zgjedhore. Asnjëra komunë nuk i'u ka përmbajtur këtij zotimi. Sfidë mbetet edhe zotimi për adresimin e kërkesave të qytetarëve në [ndreqe.com](http://ndreqe.com).